

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **635-26-5317-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me instrument për matje gjeodezike GPS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	DWH - KOSOVA SHPK
NUI	810792714
Adresa	BESELIDHJA NR.60
Vendi	PRISHTINE
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	+38344779379
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	ILIR ALLA
Adresa elektronike	kosovo@dwh-solution.com
Data e parashtrimit të ankesës	10.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me instrument për matje gjeodezike GPS

Date 3.7.2026 Njoftimi për kontrate

Date 6.7.2026 Kerkese per rishikim

Date 7.7.2026 Refuzim i Kerkeses per rishikim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkese per rishikim KR S2613276.1 date 6.7.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Baza Ligjore:

LPP të RK, Neni 7, 71 dhe si rrjedhojë neni 1

LPP të EU-se, Direktiva 2014/24/BE, Neni 81 (barazia dhe mosdiskriminimi)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

E nderuar OSHP

Ne ankimojmë vendimin e AK, KK Peje, pa numer, date 07.07.2026 dhe kërkojmë rrezimin e tij, si kthimin e tenderit në shtratin ligjor, konform Nenit 04/L-042, Neni 1, 7, 28 dhe 71.

Produktet e kerkuara nga AK jane bazuar 100% ne produkte te caktuara, ku eshte parazgjedhur prodhuesi, tipet e mjeteve te kerkuara, dhe si rrjedhoje edhe OE respektiv, si edhe jepen ne tabelen e meposhtme.

Nr.	Kerkesa	Prodhuesi	Tipi	OE
1.1	Receiveri	South	Galaxy	GjeoProjekt
1.2	Kontroller	South	S55	GjeoProjekt
1.5	Distancemates laser	Bosch	GLM 50	Gjirafamall
1.6	Rrote matese	Bosch	GWM 32	Gjirafamall
1.7	Meter metalik 5m	Bosch	5M	Gjirafamall
1.8	Metershirit 50m	Bosch	BMI/Stabil	Gjirafamall
1.9	Nivel lazer horizontal	Bosch	GRL 400H	Gjirafamall
1.10	Detektor muri	Bosch	D-Tec 120	Gjirafamall
1.11	Detektor termik	Bosch	GIS 1000C	Gjirafamall
1.12	Dron	DJI	Mavic 3	

Kjo kerkese bie ndesh me Nenin 7, 28, 71 dhe si rrjedhoje edhe me nenin 1 te LPP te RK.

Per me tej AK ne vend qe te reflektonte dhe te merrte te gjitha masat, qe te sillte tenderin ne shtratin ligjor, e ka rrezuar kerkesen tone per rishikim ne menyre arrogante dhe arbitrate pa argumentuar vendimin e vet.

AK nuk i pergjigjet me fakte kerkeses per Rishikim te OE ankimues, por e rrezon ate, duke ju referuar vetvetes me fjali parazitare si psh "specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje

me nevojat e AK" apo "ne dosje nuk jane permendur emrat e prodhuesve".

"Naiviteti" i AK eshte mbreselenes, sepse duke marre germe per germe specifikimet e produkteve te caktuara nga pozicioni 1.1 deri 1.12 dhe duke i hequr emrin e prodhuesit ose tipit te produktit, nuk eshte se ai produkt behet anonim. Ai mbetet po ai produkt.

AK ka kerkuar, qe OE te abonoje me financat e vehta GNSS e AK ne KOPOS (sherbim i AKK) per nje vit. Edhe kjo kerkese e percudnuar per AK eshte normale. Pra nese AK do te fuste ne tender edhe nje automjet levizes (Kerr) do te mund te kerkonte me kete logjike edhe karburantin per nje vit.

Cfare ndodh nese GNSS nuk do te kete akses ne Kopus ne nje moment te caktuar. linden disa pyetje:

1. Kush e ka detyrimin te per te gjetur aresyen dhe zgjidhjen? AK apo OE?
 2. Kujt i mbetet pergjegjesia per zgjidhjen?
 3. Cilat jane limitet kohore?
 4. Sa jane keto shpenzime per nje vit (vec abonimit)?
 5. A eshte ligjerisht e mundur, qe nje OE te regjistroje produkt te trete, per me teper ent publik?
 6. Cili eshte motivi, qe detyrime te tilla fikse AK ja delegon nje OE?
- Lista e pyetjeve te tilla eshte pa fund por ne po ndalemi me kaq.

Ketyre problemeve AK as qe merr persiper ti sqaroje si teknikisht edhe ligjerisht.

Ne kerkojme rrezimin e vendimit, si dhe obligimin e AK te ndryshoje kerkesat konform LPP te RK.

Pershendetje Institucionale
DWHKS Team

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*